



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**PROKURORIA PRANË GJYKATËS SË APELIT TIRANË**

**RAPORT -VJETOR**

**MBI ECURINË E PUNËS NË PROKURORINË E APELIT TIRANË**  
**PËR VITIN 2021**

**Objekti :** Raportim mbi treguesit kryesorë të punës dhe përbushjen e detyrimeve të tjera ligjore të Prokurorisë së Apelit Tiranë, për vitin 2021.

**Raportuesi :** Drejtuesi i Prokurorisë së Apelit Tiranë.

**Baza ligjore :** Neni 50/2 i ligjit nr. 97/2016, "Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë".

**Drejtuar :** Prokurorit të Përgjithshëm të Republikës së Shqipërisë,  
Z. Olsian Çela

**TIRANË**

I nderuar z.Prokuror i Përgjithshëm.

Nëpërmjet këtij raporti dhe bazuar në parashikimet e nenit 50/2, të ligjit nr.96/2016, "Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë", Prokuroria pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, Ju paraqet këtë raport analistik dhe krahasues mbi treguesit kryesorë të punës së kryer gjatë vitit 2021 nga personeli i kësaj zyre, si në

përfaqësimin e akuzës në çështjet penale objekt shqyrtimi gjyqësor në Gjykatën e Apelit Tiranë, ashtu dhe në zbatimin e detyrimeve të tjera të parashikuara në ligj dhe aktet nënligjorë, përbushjen e objektivave vjetore referuar planit të veprimit për zbatimin e Rezolutës së Kuvendit dhe Rekomandimeve prioritare të Këshillit të Ministrave në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2021 si dhe objektivat për të ardhmen.

## **1. Të dhëna dhe shpjegime për realizimin e objektivave prioritare të prokurorisë.**

Gjatë vitit 2021, nga i gjithë personeli i Prokurorisë së Apelit Tiranë, është treguar kujdesi i nevojshëm për përbushjen e detyrimeve ligjore në përfaqësimin e akuzës gjatë gjykimit në apel, por ashtu edhe për zbatimin e detyrimeve të tjera ligjore, sikurse do të analizohen më hollësisht në vijim.

### **1.1 Mbi Rezolutën e Kuvendit dhe Plan Veprimin në zbatim të tij.**

**Për efekt zbatimi të Rezolutës së Kuvendit dhe Plan Veprimit për vitin 2021, është nxjerrë Urdhërin nr. 17, datë 05.09.2021 “Për miratimin e planit të veprimit për Prokurorinë e Apelit Tiranë, për zbatimin e rezolutës së Kuvendit dhe rekomandimeve prioritare të Këshillit të Ministrave në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2021”.**

Plani i veprimit për Prokurorinë e Apelit Tiranë, për zbatimin e Rezolutës së Kuvendit dhe rekomandimeve prioritare të Këshillit të Ministrave në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2021 është hartuar mbi katër shtylla me drejtime;

- I. Garantimi i pavarësisë dhe i përgjegjshmërisë së Prokurorit.
- II. Lufta kundër korruptionit
- III. Forcimi i respektimit të të drejtave të njeriut
- IV. Mbi kërkeshat e rezolutës së Kuvendit të Shqipërisë

për se cilën prej tyre janë përcaktuar rekomandimet, masat, afatet, strukturat përgjegjëse dhe treguesit e zbatimit.

#### **1.1.2 Në lidhje me Drejtimin I:**

Garantimi i pavarësisë dhe i përgjegjshmërisë së Prokurorit janë dy rekomandime që lidhen me ngritjen profesionale përmes trajnimeve në Shkollën e Magjistraturës ,  
Adresa : Rruga “Qemal Stafa” Nr.1, Tiranë

website : [www.pp.gov.al](http://www.pp.gov.al)

Institucionale/Organizata Ndërkombëtare të prokurorëve si dhe forcimi i mekanizmave të informimit dhe kontrollit të veprimtarisë gjyqësore të prokurorit me qëllim garantimin e paanshmërisë dhe shmangien e cdo lloj ndikimi gjatë kryerjes së detyrës.

Të dy këto rekomandime kanë si afat zbatimi në vijimësi, për shkak se janë procese vazhduese.

Prokuroria e Apelit Tiranë ka patur efektivisht në përbërje 3 prokurorë me përvojë, e pavarësisht kësaj i është kushtuar vëmëndje e veçantë bashkëpunimit me Shkollën e Magjistraturës për formimin vazhdues të tyre. Konkretnisht kemi identifikuar temat prioritare për të cilat kemi interes për temat që lidhen me ndjekjen e veprave penale të korruptionit, të dhunës në familje, të krimeve me të mitur, si dhe me natyrë gjinore dhe seksuale etj.

Duhet pranuar se nga ana e prokurorëve të Prokurorisë së Apelit Tiranë, për shkak dhe të problematikës që është konstatuar me sistemin kompjuterik ( pajisjet kompjuterike në përdorim të prokuroeve u mungojnë kartat, zëri dhe pajistet e kamerave ) kanë sjelle si pasojë shumë vështirësi në ndjekjen online të seminareve trajnues të Shkollës së Magjistratuës.

Me fillimin e procesit trajnues në sallat e Shkollës së Magjistratuës, nga ana e prokurorëve është bërë përzgjidhja e temave prioritare dhe do tregohet vemëndja maksimale për ndjekjen e tyre.

**1.1.3 Rekomandimi nr.2**, është zbatuar deri më tani përmes një bashkëpunimi shumë të ngushtë, koordinimi të qartë veprimesh mes prokurorëve duke siguruar mbarëvajtjen e çështjeve penale që janë trajtuar gjatë kësaj periudhe. Edhe pse Prokuroria e Apelit Tiranë gjatë kësaj periudhe ka patur vakanca të theksuara në numrin e prokurorëve, ky fakt nuk është reflektuar në punën e tyre, duke patur një shpërndarje të drejtë pune, bashkë me realizimin e takimeve periodike për diskutim të çështjeve.

#### **1.1.4 Drejtimin II: Lufta kundër korruptionit.**

Në këtë drejtim janë përcaktuar tre rekomandime të cilat përfshijnë, zhvillimin e kapaciteteve profesionale përmes trajnimeve, ndjekjen me përparësi të çështjeve penale

që kanë lidhje me zgjedhjet e lira dhe sistemin zgjedhor dhe forcimin e cilësisë së gjykimit për veprat penale në fushën e korruptionit.

Zbatimi i Rekomandimit nr.1 është në proces, si në shpjegimin e Rekomandimit nr.1 të Drejtimin I-rë.

Për Rekomandimin nr.2, gjatë kësaj periudhe janë trajtuar çështje penale (masë sigurimi), që lidhen me zgjedhjet e lira dhe procesin zgjedhor, për të cilat në të gjitha rastet është mbajtur qëndrim i njëjtë me prokurorin e shkallës së parë duke vlerësuar rëndësinë e çështjeve. Kemi gjykuar vetëm dy raste me objekt caktim mase sigurimi në ngarkim të një personi nën hetim për veprën penale "Shkelja e fshehtësisë të votimit" dhe "Kanosja apo dhunimi ndaj pjesmarrësve në zgjedhje", parashikuar nga nenet 327/1 dhe 329/2 të Kodit Penal.

Për Rekomandimin nr.3, gjatë kësaj periudhe, nga prokurorët e Prokurorisë Apelit Tiranë janë përfaqsuar në gjykim çështje penale me objekt korruptionin. Këto çështje lidhen me konsumimin e veprës penale sipas nenit 244 të Kodit Penal. Kryesisht rastet kanë të bëjnë me qytetarët që kanë tentuar tu japid përfitime të parregullta efektivëve të policisë rrugore për të shmangur shkeljet administrative, dhe në të gjitha rastet vlera monetare e përfitimit të parregullt ka qenë shumë e vogël. Për këto raste, qëndrimi i mbajtur nga prokurorët ka qenë në raport të drejtë me rrethanat e faktit dhe rrezikshmërinë shoqërore që paraqiste subjekti i veprës penale.

### **1.1.5 Drejtimin III: Forcimi i respektimit të të drejtave të njeriut.**

Janë përcaktuar dy rekomandime që lidhen me nxitjen e aplikimit të dënimive alternative në rastet e veprave penale dhe/ose autorëve me rrezikshmëri të ulët shoqërore, veçanërisht në rastet e të miturve, personave vulnerabël dhe personave me probleme shëndetësore. Ndërkohë që është vijuar me ashpërsimin e masave të sigurimit dhe masës së dënitit për veprat me natyrë gjinore, seksuale dhe diskriminuese, si dhe në rastet e keqtrajtimit/abuzimit/shfrytëzimit e trafikimit të fëmijëve.

Për rekomandimin nr.1, gjatë kësaj periudhe janë trajtuar disa çështje penale ku në rastet e veprave penale dhe autorëve me rrezikshmëri të ulët shoqërore, veçanërisht në rastet e të pandehurve të mitur, janë aplikuar dënimet alternative. Për të miturit vëmendje e veçantë u janë kushtuar dispozitave ligjore të parashikuara në Kodin e Drejtësisë Penale për të Mitur.

Për rekomandimin nr.2, gjatë kësaj periudhe janë trajtuar disa çështje penale. Për këto çështje penale qëndrimet e mbajtura nga prokurorët e apelit lidhur me masat e sigurimit dhe masat e dënimit kanë qenë ashpërsuese, duke iu përgjigjur rrezikshmërisë së veprave dhe autorëve të tyre. Në rastet kur çështjet kanë ardhur në apel me ankimin e të pandehurve/personave nën hetim, qëndrimi i mbajtur nga prokurorët e apelit pothuajse në të gjitha rastet ka qenë lënia në fuqi ose miratimi i vendimit të gjykatës së shkallës së parë, dhe në rastet kur çështja në apel ka ardhur mbi ankimin e prokurorit të shkallës së parë, ankimet përgjithësisht janë mbështetur nga prokurorët e apelit.

#### **1.1.6 Drejtimin IV: Mbi kërkesat e rezolutës së Kuvendit të Shqipërisë.**

Rekomandimi nr.1 lidhet me miratimin e Udhëzimit të Përgjithshëm të drejtuesit të Prokurorisë së Apelit Tiranë me qëllim evidentimin e problematikave, shqetësimeve që hasin prokurorët në kuptimin dhe zbatimin e dispozitave të reja të ligjit penal dhe procedural. Si mase monitoruese dhe ndjekese e punës së prokurorëve është hartimi dhe mbajtja e një rregjistri të veçantë me qëllim monitorimin dhe ndjekjen e të gjithë fazave në të cilat kalon një çështje penale, përfshirë këtu dhe rekursin për në Gjykatën e Lartë të vendim-marrjes së Gjykatës së Apelit Tiranë, në ato raste kur nuk përputhet me qëndrimin e prokurorit. Në këtë kuadër ka shërbyer dhe përmirësimi gjatë kësaj periudhe i komunikimit të vendimeve të kësaj gjykate, prokurorit të apelit në kohë dhe në formë shkresore.

Rekomandimi nr.2 lidhet me standartizimin e procedurave të funksionimit nga pikëpamja administrative për unifikimin e volumit të punës dhe normalizimin e veprimtarisë së prokurorit. Si masë e parashikuar ishte hartimi i një udhëzimi me qëllim përcaktimin e normës, volumit orientues të punës së një prokurori. Sa i takon zbatimit të këtij rekomandimi, duhet theksuar se situata e Prokurorisë së Apelit Tiranë, vazhdon të mbetet e vështirë, pasi ka patur efektivë vetëm 3 prokurorë (vetëm në fund të vitit janë emëruar dy prokurorë të tjera, ndërsa një prokuore është caktuar si prokuore ndërlidhëse pranë Eurojust), nga 9 prokurorë në strukturë, e cila e bën aktualisht të pamundur, përgatitjen e një udhëzimi të përgjithshëm efikas dhe real për përcaktimin e normës/volumit orientues të punës në prokurori, me qëllim që të mos cënohet cilësia e përfaqësimit të akuzës në Gjykatën e Apelit.

Monitorimi i punës së prokurorëve aktualë vijon të jetë i vazhdueshëm dhe do të shërbejë në të ardhmen për përgatitjen e një udhëzimi të përgjithshëm "Për përcaktimin e normës,

volumit orientues të punës në prokurori", siç përcaktohet edhe në Rezolutën e Kuvendit të Shqipërisë.

Vendi vakant për më shumë se dy vjet i Kacelarit të Prokurorisë së Apelit Tiranë, vakancë e njojur dhe nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë, ka sjellë problematikë në mirëfunksionimin e administratës së kësaj prokurorie. Plotësimi i strukturës, do të sillte efikasitet në ndjekjen e problematikave të natyrës administrative dhe zgjidhjen e tyre. Gjithashtu nisur nga fakti i një stafi shumë të kufizuar të prokurorëve edhe vetë Drejtuesi i Prokurorisë gjatë kësaj periudhe ka marrë ngarkesë të njëjtë me prokurorët, ndërkokë që është dhe anëtar i Këshillit të Lartë të Emërimeve në Drejtësi, funksion që kërkon një përkushtim në kohë dhe seriozitet për shkak të rëndësisë që ka.

## **1.2 Zbatimi i Udhëzimeve të Prokurorit të Përgjithshëm mbi rekomandimet prioritare të Këshillit të Ministrave.**

Bazuar në Urdhërin nr.79 datë 09.07.2021 të Prokurorit të Përgjithshëm "Për miratimin e planit të veprimit për zbatimin e "Rekomandimeve prioritare të Këshillit të Ministrave në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2021" dhe Udhëzimin nr.04, datë 09.07.2021 të Prokuorit të Përgjithshëm "Për rekomandimet prioritare të Këshillit të Ministrave në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2021 në prokuroritë e juridiksonit të përgjithshëm", në zbatim të nenit 10 të aktit lartpërmendur, Drejtuesi i Prokurorisë Apelit Tiranë ka nxjerrë aktin administrativ për lehtësimin e zbatimit të këtij udhëzimi të përgjithshëm e konkretisht :

- **Urdhëzimin e Përgjithshëm Nr.19, datë 28.07.2021** "Për zbatimin e Udhëzimit të Përgjithshëm nr.4 datë 09.07.2021 "Për rekomandimet prioritare të Këshillit të Ministrave në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2021 në prokuroritë e juridiksonit të përgjithshëm".

Në këtë udhëzim janë përcaktuar masat administrative dhe procedurale, që duhet të merren për realizimin e përparësive me qëllim sigurimin e zbatimit të rekomandimeve prioritare sipas fushës së kompetencës së Prokurorisë së Apelit Tiranë, duke synuar një mënyrë vlerësimi të ndjekjes penale që çon në rritje të eficensës së luftës kundër kriminalitetit.

Gjithashtu ky udhëzim ka përcaktuar dhe mënyrat dhe format e komunikimit të prokurorëve me drejtuesin e prokurorisë si në aspektin e monitorimit të punës ashtu dhe për problematikave që do të dilnin gjatë gjykimit të çështjeve nga Gjykata e Apelit Tiranë.

### **1.2.1 Masat Administrative në lidhje me aktet e Prokurorit të Përgjithshëm ;**

e më konkretisht Urdhërit nr.79 datë 09.07.2021 "Për miratimin e planit të veprimit për zbatimin e "Rekomandimeve prioritare të Këshillit të Ministrave në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2021" dhe Udhëzimit nr.04, datë 09.07.2021 "Për rekomandimet prioritare të Këshillit të Ministrave në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2021 në prokuroritë e juridiksonit të përgjithshëm", nga ana e drejtuesit këto akte janë shpërndarë për njohje dhe vlerësim stafit të prokurorëve të Prokurorisë së Apelit Tiranë, dhe në mbledhjen e datës 03.09.2021 janë miratuar masat administrative për zbatimin e rekomandimeve prioritare.

Këto akte janë bërë të njohura dhe stafit mbështetës të Prokurorisë së Apelit.

### **1.2.2 Në lidhje me Informimin në Prokurorinë e Përgjithshme ;**

Gjatë periudhës kohore pas daljes së Urdhërit nr.79 datë 09.07.2021 "Për miratimin e planit të veprimit për zbatimin e "Rekomandimeve prioritare të Këshillit të Ministrave në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2021" dhe Udhëzimit nr.04, datë 09.07.2021 "Për rekomandimet prioritare të Këshillit të Ministrave në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2021 në prokuroritë e juridiksonit të përgjithshëm", nga ana e Prokurorisë së Apelit Tiranë janë dërguar në Prokurorinë e Përgjithshme informacionet përkatëse analitike dhe të detajuara të veprimtarisë së Prokurorisë së Apelit Tiranë për periudhat 3, 6, 9 dhe 12 mujore.

Krahas sa më lart, është dërguar informacion për zbatimin e urdhërit nr.78, datë 09.07.2021 të Prokuorit të Përgjithshëm "Për miratimin e planit të veprimit për zbatimin e Rezolutës së Kuvendit dt 14.06.2021", në të cilën janë pasqyruar të dhëna të hollësishme dhe analitike, të dhëna që përbëjnë dhe prioritete të përbashkëta mes Rezolutës së Kuvendit datë 14.06.2021 dhe Rekomandimeve Prioritare të Këshillit të Ministrave në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2021.

### **1.2.3 MASAT PROCEDURIALE**

#### **Garantimi i pavarësisë dhe i përgjeshmërisë së prokurorit**

Në lidhje me respektimin e parashikimeve të Prokurorit të Përgjithshëm Nr.12 datë 20.07.2021, mbi mënyrën e informimit të Drejtuesve në Prokurori, dhe të Rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë pranë Gjykatës së Apelit Tiranë” si në lidhje me qëndrimin e prokurorit për masat e sigurimit ashtu dhe me çështjet e themelit, për veprat penale prioritare të rekomanduara sipas ligjit dhe në kuadrin e forcimit të mekanizmit të kontrollit dhe llogaridhënieς, duke garantuar paanshmërinë dhe shhangjen e çdo lloj influence apo ndikimi ndaj prokurorit gjatë gjykimeve në drejtimet prioritare të rekomanduara në nenin 7 “Masat proceduriale të prokurorit” e Udhëzimit të Përgjithshëm nr.04 datë 09.07.2021 të Prokurorit të Përgjithshëm, në respektim dhe të parashikimeve të nenit të 18, pika 1 dhe 2 të Udhëzimit të Përgjithshëm nr.12 datë 20.07.2020 të Prokurorit të Përgjithshëm, Ju bëjmë me dije se, për periudhën kohore që kërkohet, nga ana e prokurorëve të Prokurorisë se Apelit Tiranë është respektuar detyrimi i tyre për informimin paraprak të Drejtuesit të Prokurorisë për qëndrime të ndryshme nga ankimi i prokurorit të shkallës së parë apo dhe vetë vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë, për çdo çështje të përfaqesuar, pavarësisht rëndësisë apo të qenit prioritare.

Për periudhën kohore që kërkohet informacioni nga ana Juaj, bëj me dije se nuk ka patur raste kur qëndrimi ligjor i prokurorit të shortuar për përfaqësimin e çështjeve penale lartpërmendur ( qofshin kërkesa penale, çështje themeli apo dhe masa sigurimi ) të ketë qënë i ndryshëm nga ai i Drejtuesit të Prokurorisë, çka do sillte dhe më pas nxjerrjen e udhëzimeve jo të detyrueshme nga ky i fundit apo dhe të informimit të mëpasshëm të Prokurorit të Përgjithshëm apo dhe institucioneve të ngarkuara me ligj.

Në lidhje me praktikën e ndjekur nga ana e drejtuesit, mbi pasqyrimin e qëndrimit të tij përkundrejt informacionit të dërguar nga ana e prokurorit të apelit që ka përfaqësuar çështjen, Ju informoj se në mugës së tij rasteve ku ka patur mosdakortësi apo mendim ndryshe me prokurorët e seancës, nuk ka patur shkak të nxirreshin udhëzime jo detyruese.

Edhe në rast se i referohemi rregjistrat të qarkullimit të brendshëm, ai është i konceptuar në mënyrë të atillë, ku në rubrikën e qëndrimit të drejtuesit, parashikohen vetëm rastet kur drejtuesi, pasi informohet, nxjerr udhëzimin përkatës jo të detyrueshëm, kur ka qëndrim ndryshe dhe jo rastet e dakortësisë.

Për më tepër, si Udhëzimi i Përgjithshëm nr.12 datë 20.07.2020 i Prokurorit të Përgjithshëm, ashtu dhe aktet e dala në zbatim të tij, kanë si qëllim të vetëm të mundësojnë drejtuesit të informohet dhe të reagojë ndaj qëndrimeve të prokurorëve të seancave, për rastet kur ai i konsideron jo të drejta.

**Ndërkohë** është zbatuar deri më tanë përmes një bashkëpunimi shumë të ngushtë, koordinimi të qartë veprimesh mes prokurorëve duke siguruar mbarëvajtjen e çështjeve penale që janë trajtuar gjatë kësaj periudhe. Edhe pse Prokuroria e Apelit Tiranë gjatë kësaj periudhe ka patur vakanca të theksuara në numrin e prokurorëve, ky fakt nuk është reflektuar në punën e tyre, duke patur një shpërndarje të drejtë pune, bashkë me realizimin e takimeve periodike për diskutim të çështjeve.

Parashtrojmë në mënyrë të përbledhur, treguesit e përgjithshem të punës ne Prokurorinë e Apelit Tiranë, për periudhën Janar - Dhjetor vitin 2021, për veprat penale në luftën kundër: korupsionit, krimit të organizuar, pastrimit të parave, trafikimit, lëndëve narkotike, terrorizmit, nxitjes së urrejtjes, familjes dhe mjedisit, sipas rekomandimeve të Këshillit te Ministrave të përmendor më lart, të dhënat për të cilat janë pasqyruar saktësisht në këtë raportim, në rubrikën volumi punës.

Në këtë drejtim janë përcaktuar tre rekomandime të cilat përfshijnë, zhvillimin e kapaciteteve profesionale përmes trajnimeve, ndjekjen me përparësi të çështjeve penale që kanë lidhje me zgjedhjet e lira dhe sistemin zgjedhor dhe forcimin e cilësisë së gjykimit për veprat penale në fushat lartpëmendur.

### **1.2.5 Rastet e Gjykimeve të Drejtëpërdrejta**

Prokurorët, në respektim të pavarësisë së tyre të brendëshme, kanë mbështetur rastet e gjykimeve të drejtëpërdrejta dhe zbatimin e insituteve proceduriale penale, duke vlerësuar kushtet dhe kriteret ligjore dhe synimet prioritare të rekomanduara por duhet theksuar se numri i këtij lloj gjykimi që vjen për shqyrtim në Gjykatën e Apelit është minimal.

Duhet theksuar, se rastet e gjykimit të drejtëpërdrejtë, vijnë për shqyrtim në Gjykatën e Apelit, vetëm mbi bazën e ankimit të palëve në proces për masën e sigurimit të dhënë, pasi ankimet për themelin e çështjes, janë të rralla dhe objekt i tyre është thjesht masa e dënimit të dhënë.

## **1.2.6 Forcimi i respektimit të të drejtave të njeriut.**

Janë përcaktuar dy aspekte që lidhen me nxitjen e aplikimit të dënimive alternative në rastet e veprave penale dhe/ose autorëve me rrezikshmëri të ulët shoqërore, veçanërisht në rastet e të miturve, personave vulnerable dhe personave me probleme shëndetësore. Ndërkohë që është vijuar me ashëpërsimin e masave të sigurimit dhe masës së dënitit për veprat me natyrë gjinore, seksuale dhe diskriminuese, si dhe në rastet e keqtrajtimit/abuzimit/shfrytëzimit e trafikimit të fëmijëve.

Gjatë kësaj periudhe janë trajtuar disa çështje penale ku në rastet e veprave penale dhe autorëve me rrezikshmëri të ulët shoqërore, veçanërisht në rastet e të pandehurve të mitur, janë aplikuar dënimet alternative. Për të miturit vëmendje e vecantë u janë kushtuar dispozitave ligjore të parashikuara në Kodin e Drejtësisë Penale për të Mitur.

Gjatë kësaj periudhe janë trajtuar disa çështje penale për veprat me natyrë gjinore, seksuale dhe diskriminuese. Për këto çështje penale qëndrimet e mbajtura nga prokurorët e apelit lidhur me masat e sigurimit dhe masat e dënitit kanë qenë ashëpërsuese, duke iu përgjigjur rrezikshmërisë së veprave dhe autorëve të tyre. Në rastet kur çështjet kanë ardhur në apel me ankimin e të pandehurve/personave nën hetim, qëndrimi i mbajtur nga prokurorët e apelit pothuajse në të gjitha rastet ka qenë lënia në fuqi ose miratimi i vendimit të gjykatës së shkallës së parë, dhe në rastet kur çështja në apel ka ardhur mbi ankimin e prokurorit të shkallës së parë, ankimet përgjithësisht janë mbështetur nga prokurorët e apelit.

Në lidhje me verifikimin sistematik të ecurisë dhe përfundimit të çështjeve në gjykim për veprat penale prioritare të rekomanduara, janë monitoruar në vecanti, afatet proceduriale në Gjykatën e Apelit, kryesisht me afatet e paraburgimit.

Në këtë aspekt, duke patur në konsideratë faktin se vetë Gjykata e Apelit ka mbetur me një trupë prej 6 gjyqtarësh, ( gjithsej dy trupa gjykuese, ku një prej tyre është i angazhuar dhe me masat e sigurimit ) ka bërë që t'i jepet prioritet gjykimeve penale me persona të cilët janë me masën e sigurimit “arrest në burg” dhe ato që kanë të bëjnë me ekstradimet dhe njohjet e vendimeve penale të huaja.

Pra në këtë situatë, dhe çështjet që dalin për shqyrtim, janë të kushtëzuara nga masa e sigurimit, faktor që ana tjetër ndikon në respektimin e afateve të gjykimit të çështjeve me të paraburgosur dhe sjell si pasojë dhe një respektim të të drejtave të tyre proceduriale për një gjykim të shpejtë.

Për nga numri dhe rëndësia e çështjeve që trajtojmë, ne mbetemi një hallkë e rëndësishme, pasi shqyrtojmë numrin më të madh të çështjeve në rang vendi që gjykohen në shkallë të dytë.

### **1.2.7 Përfaqësimin e akuzës gjatë gjykimit në apel dhe respektimin e afateve ligjore,**

gjatë vitit 2021, nga Prokuroria e Apelit Tiranë, janë respektuar me korrektesë detyrimet e ligjit procedural penal, si dhe urdhërat dhe udhëzimet e Prokurorit të Përgjithshëm, për respektimin e afateve në shqyrtimin e çëshjeve të ankimuara.

Sa më sipër kryesisht, por jo vetëm, për :

prezencën e prokurorëve në të gjitha seancat gjyqësore në Gjykatën e Apelit, si për çështjet e themelit, për masat e sigurimit apo ankimet e veçanta dhe kërkesa të tjera penale, duke respektuar solemnitetin dhe etikën në gjykim,

për nxjerrjen në kohë të urdhërave të ekzekutimit në zbatim të vendimeve të Gjykatës së Apelit,

dërgimin e vendimeve penale në Prokuroritë e rretheve gjyqësore kompetente,

ushtrimin brenda afateve ligjore të së drejtës së rekursit në Gjykatën e Lartë.

Gjatë kësaj periudhe kohore nuk ka patur raste të moszhvillimit të seancave gjyqësore për shkak të mungesës për arsyet joobjektive të prokurorëve, por duhet theksuar se ky vit ka patur një veçanti, epideminë Covid 19, që përfshiu vardin tonë e që në mënyrë të pashmangshme, preku dhe ecurinë e aktivitetit gjyqësor në tërsi dhe në Gjykatën e Apelit Tiranë, në veçanti.

Gjithashtu nuk ka patur asnjë rast gjatë vitit 2021 që ndaj prokurorëve, apo punonjësve të tjerë të Prokurorisë së Apelit Tiranë, të jetë inicuar procedimi disiplinor apo të jenë marrë masa disiplinore nga organet komptente sipas ligjit, për shkaqet e përmendura më sipër.

### **1.2.8 Rekurset**

Në rastet e parashikuara nga ligji dhe kur vendimet e Gjykatës së Apelit kanë qenë të ndryshme nga kërkimet e akuzës, është ushtruar rekurs në Gjykatën e Lartë për çështjet respektive, gjithnjë duke patur në konsideratë se tashmë, Gjykata e Lartë pranon për shqyrtim çështje vetëm kur konstaton shkelje të parashikimeve të nenit 432 i Kodit të

Procedurës Penale, çka ka sjellë dhe një reduktim të mundësisë ligjore për ushtrimin e rekursit.

Kjo dispozitë, në pikën 1 të tij, parashikon se rekursi kundër vendimit të Gjykatës së Apelit mund të bëhet kur nuk është respektuar ose është zbatuar gabim ligji material ose procedural i cili është me rëndësi për njësimin ose zhvillimin e praktikës gjyqësore; kur nuk është respektuar ose është zbatuar gabim ligji procedural me pasojë pavlefshmërinë e vendimit, pavlefshmërinë absolute të akteve ose papërdorshmërinë e provave; ose kur vendimi i ankimuar vjen në kundërshtim me praktikën e Kolegjit Penal ose të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

Në kuadër dhe të ndryshimeve që pësoi Kodi i Procedurës Penale, janë nxjerrë dy urdhëra që normojnë administrimin e vendimeve të Gjykatës së Apelit, ( pra momenti i depozitimit të tyre në formë të plotë dhe të arsyetuar ) si dhe rekursve të paraqitura nga palët në proces.

Për këtë qëllim, në zbatim të urdhërimeve lartpëershkruar, janë krijuar dy rregjistra të posaçëm, ku në njërin pasqyrohet saktësish data e depozitimit të vendimeve gjyqësore të Gjykatës së Apelit, me qëllim përllogaritjen e saktë të afatit të rekursit dhe në tjetrin, momenti i depozitimit të rekursit të palëve, me qëllim realizimin e kundër rekursit kur shihet e novojshme nga ana e prokurorëve.

#### **1.2.8 Bashkëpunimin me institucionet e tjera,**

Gjatë vitit 2021 kanë vijuar raportet korakte me institucione të tjera, në zbatim të ligjt procedural dhe atij organik për Prokurorinë. Në keto marrëdhënie rolin kryesor e zënë ato që lidhen me;

- Gjykatën e Apelit Tiranë, për fazën që lidhet me përfaqësimin e akuzës në gjykimin e çështjeve të ankimuara, si dhe të detyrimeve të përbashkëta administrative për mbarëvajtjen e punës.
- Prokuroritë e rretheve gjyqësore, që veprojnë në juridikcionin e Apelit Tiranë, për bashkëveprimin në funksion të përfaqësimit sa më të mirë të akuzës në çështjet e ankimuara, veprimtarisë në fushën e ekzekutimit të vendimeve penale dhe detyrimeve të tjera ligjore të prokurorit.

- Strukturat e Policisë së Shtetit dhe institucionet e tjera që përfshijnë shërbime të Policisë Gjyqësore, për zbatimin e urdhërave për ekzekutimin e vendimeve penale.
- Me Institucionet e Ekzekutimit të Vendimeve Penale, për fazën e ekzekutimit.
- Me Prokurorinë e Përgjithshme, si institucioni që përfaqëson çështjet e rekursuara, si dhe në bashkëpunimin për çështje të tjera të natyrës administrative.
- Me institucionet e tjera, në funksion të përmbushjes së detyrimeve ligjore.

### **1.2.9 Bashkëpunimi me Gjykatën e Apelit Tiranë.**

Sikurse u përmend edhe më sipër, raportet e kësaj zyre me Gjykatën e Apelit Tiranë, kanë qenë korakte dhe ligjore, në përfaqesimin e akuzës në gjykimet në apel dhe plotësimin e detyrimeve të tjera ligjore.

Nga ana e prokurorëve, janë bërë përpjekje maksimale për të mundësuar pjesëmarrjen e tyre në kohën në gjykim, respektimin e solemnitetit të tij, ruajtjen e sekretit për vendimet që lidhen me akte të asaj natyre të hetimeve paraprake, procedurat për dërgimin në organet kompetente të vendimeve penale me ekzekutim të menjëhershëm etj.

Në këtë aspekt, duhet thënë se Prokuria e Apelit Tiranë dhe Gjykata e Apelit Tiranë, ka qënë në fokusion e procesit të vetingut, duke u ndjerë ky proces dhe në mbarvajtjen e shqyrtimit gjyqësor në kohë.

Po ashtu një vëmendje e posaçme i është kushtuar përmbushjes së detyrimeve të përbashkëta ligjore në fushën e administrimit të drejtësisë, transparencën ndaj publikut.

Duke e konsideruar të rëndësishëm këtë aspekt, është përcaktuar dhe kordinatori për të drejtën e informimit dhe prokurori i medias.

### **1.2.10 Bashkëpunimi me Prokuroritë e Rretheve Gjyqësore të Juridikzionit të Apelit Tiranë.**

Edhe gjatë vitit 2021 kanë vijuar raportet e bashkëpunimit me të gjitha Prokuroritë e rretheve të juridikzionit të apelit, për trajtimin e problematikave që hasen në gjykimin e çështjeve të ankimuara, si për qëllime të rritjes së nivelit cilësor të apelimeve, shkëmbimit

të informacioneve për fazën e çështjeve konkrete, dërgimit të njoftimeve për fazën e ekzekutimit të vendimeve penale etj.

Gjatë kësaj periudhe kemi gjetur mirëkuptimin e plotë të drejtuesve dhe prokurorëve të zyrave përkatëse për përmirësimin e problematikave të hasura, si rritjen e nivelit cilësor të apelimeve, parashtrimit të të gjitha shkaqeve ligjorë në to, ushtrimin e apelimeve për masat e sigurimit vetëm për rastet e domosdoshme të hetimit paraprak, përmirësimin e komunikimit dhe njoftimit të zyrave respektive për rrethanat e gjykimit, në Shkallën e Parë dhe në Apel etj.

#### **1.2.11 Bashkëpunimi me strukturat e Policisë së Shtetit.**

Raportet me strukturat e Policisë së Shtetit në Drejtoritë Vendore të Policisë së Qarqeve Tiranë, Kurbin, Krujë, Dibër dhe Mat gjatë vitit 2021 kanë qenë tërësisht korrekte dhe ato janë shtrirë kryesisht në fushën e njoftimit të palëve në fazën e gjykimit dhe shkëmbimit të të dhënavë që lidhen me fazën e ekzekutimit të vendimeve penale nga prokurorët e apelit, apo në bashkërendimin e veprimeve në funksion të administrimit të drejtësisë.

#### **1.2.12 Bashkëpunimi me Institucionet e Ekzekutimit të Vendimeve Penale.**

Raportet me Institucionet e Ekzekutimit të Vendimeve Penale Tiranë, Kurbin, Krujë, Dibër dhe Mat gjatë vitit 2021, kanë qenë bashkëpunuese dhe korrekte dhe ato janë shtrirë në të gjitha aspektet ku ligji e parashikon këtë bashkëpunim, përfshirë atë të njoftimeve, shkëmbimit të informacioneve të nevojshme për çështjet, në fushën e ekzekutimit të vendimeve penale dhe në kompetencë të prokurorëve të apelit, sikurse janë ato për masat e sigurimit apo udhërimet e tjera të gjykatës etj.

#### **1.2.13 Bashkëpunimi me Prokurorinë e Përgjithshme.**

Gjatë vitit 2021 ka vijuar raporti i ngushtë i bashkëpunimit me Prokurorinë e Përgjithshme.

Ky bashkëpunim është shtrirë jo vetëm me Prokurorin e Përgjithshëm dhe Drejtorinë Gjyqësore apo me Drejtorinë e Marrëdhënieve Juridikionale me Jashtë për shkëmbimin e të dhënavë në atë fushë, por edhe me të gjitha drejtoritë dhe sektorët e tjërë të Prokurorisë së Përgjithshme.

Pikërisht edhe në sajë të këtij bashkëpunimi dhe plotësimit të nevojave administrative nga sektorët e tjera të Prokurorisë së Përgjithshme, është bërë e mundur përballimi i një volumi të konsiderueshëm në punë nga Prokuroria e Apelit Tiranë, sidomos në lidhje me proceset e njohjeve të vendimeve penale të huaja, duke mundëuar informimin dhe realizimin në kohë të shqyrtimit gjyqësor të këtyre proceseve, për të cilat ligja proceduriale parashikon afate kohore të shkurtra.

Edhe gjatë vitit 2021 janë respektuar detyrimet e prokurorëve për të zbatuar në kohë dhe me cilësi urdhërat dhe udhëzimet e Prokurorit të Përgjithshëm, lidhur me ushtrimin e funksioneve të prokurorit në apel.

#### 1.2.13      **Bashkëpunimi me institucionet e tjera.**

Gjatë vitit 2021 është përmbushur në mënyrë korrekte përfaqësimi i Prokurorisë së Apelit në raport me institucionet e tjera, të nivelit qëndror apo vendor, në zbatim të detyrimeve të ligjit organik për Prokurorinë.

Gjatë vitit 2021 një rëndësi e veçantë i është dhënë bashkëpunimit me prokurorin ndërlidhës pranë EUROJUST, ku në sajë të këtij bashkëpunimi, në dy çështje penale, me objekt njohje vendimesh penale të huaja, është bërë e mundur realizimi në kohë i procesit gjyqësor dhe administrimi i vendimeve penale të autoriteve gjyqësore të huaja të pretenduara gjatë procesit nga palët në gjykim.

## 2.      ANALIZA E TREGUESVE TË VOLUMIT TË PUNËS.

Treguesit e volumit të përgjithshëm të punës, të kryer nga prokurorët për vitin 2021, përfshijnë të dhënat për sa më poshtë vijon :

Referuar llojtit të veprave penale rezulton se veprat penale në fushën e "Korrupsionit", "Pastrimit të parave", "Lirisë së personit dhe trafikimit", kundër "Familjes" dhe "Lëndëve narkotike" zënë numrin më të madh të çështjeve që janë bërë objekt gjykimi në Gjykatën e Apelit Tiranë.

- **Për veprat penale për gjykime themeli, në fushën e "Korrupsionit", Neni 248; i K.Penal, të përfundura në vitin 2021, në Prokurorinë e Apelit Tiranë, janë 1 çështje gjithsej.**

- Për gjykimet masë sigurimi, që i përkasin veprave penale në fushën e "Korrupsionit" nenet 244; 248; 259/a; të K.Penal të përfundura në vitin 2021, në Prokurorinë e Apelit Tiranë, janë 10 çështje gjithsej.
- Për gjykimet masë sigurimi, që i përkasin veprave penale në fushën e "Pastrimit të parave" nenet 287; të K.Penal, të përfundura në vitin 2021 janë 3 çështje gjithsej.
- Për veprat penale për gjykime themeli, që i përkasin veprave penale, në fushën e "Lirisë së personit dhe trafikimit", nenet 109/b; 110/a; 128/b; 141/a; 278/a; 278/1; 278/3; 278/4; të K.Penal të përfundura në vitin 2021 janë 22 çështje gjithsej.
- Për gjykimet masë sigurimi, që i përkasin veprave penale, në fushën e "Lirisë së personit dhe trafikimit", nenet, 109; 109/2; 110/a; 278/a; 278/a/2; 278/1; 278/3; 278/4; 278/6; 288 të K.Penal, të përfundura në vitin 2021 janë 37 çështje gjithsej.
- Për veprat penale për gjykime themeli, në fushën e "Lëndëve narkotike" nenet 283; 283/1; 283/2; 284; 284/1; 284/2; të K.Penal të përfundura në vitin 2021 janë 38 çështje gjithsej.
- Për gjykimet masë sigurimi, në fushën e "Lëndëve narkotike" nenet 283; 283/1; 283/2; 284; 284/1; 284/2; 284/d/2; 285; të K.Penal, të përfundura në vitin 2021 janë 141 çështje gjithsej.
- Për veprat penale për gjykime themeli, që i përkasin veprave penale kundër "Familjes"nenet 124; 128;130; 130/a; 130/a/1, 130/a/1/2; 130/a/2/3; 130/a/3; 130/a/4 të K.Penal, të përfundura në vitin 20021, janë 42 çështje gjithsej.
- Për gjykimet masë sigurimi, që i përkasin veprave penale në fushën e "Familjes"nenet 130/a; 130/a/1, 130/a/2; 130/a/3; 130/a/4 të K.Penal, të përfundura në vitin 20021, janë 126 çështje gjithsej.

2.1 Në total gjatë vitit 2021, nga Prokurorët e Apelit është përfaqësuar akuza në çështjet në gjykim pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, për **1498** çështje nga të cilat :

- **349** çështje themeli gjithsej, **me 431** të pandehur.
- **1149** çështje (me 1422 persona) të masave të sigurimit.

2.2. Duke krahasuar numrin e çështjeve të gjykuara në Gjykatën e Apelit Tiranë me vitin 2020, ku janë gjykuar **279 çështje penale në themel, me 344 të pandehur**, numri i çështjeve ka një rritje prej 70 çështje .

Të ndarë sipas rrtheve, krahasuar numrin e çështjeve të gjykuara në Gjykatën e Apelit Tiranë me **vitin 2020**:

1. **Tirana** 245 çështje në vitin 2020, në 268 çështje në vitin 2021, ka një rritje prej 23 çështje.
2. **Kruja** 9 çështje në vitin 2020, në 28 çështje në vitin 2021, ka një rritje prej 19 çështje.
3. **Kurbini** 10 çështje në vitin 2020, në 27 çështje në vitin 2021, ka një rritje prej 17 çështje.
4. **Dibra** 5 çështje në vitin 2020, në 10 çështje në vitin 2021, ka një rritje prej 5 çështje.
5. **Mati** 10 çështje në vitin 2020, në 16 çështje në vitin 2021, ka një rritje prej 6 çështje.

Persa i përket masave te sigurimit në Gjykatën e Apelit janë gjykuar **1149 masa sigurimi personal**. Krahasuar me **vitin 2020** ku janë gjykuar **1009 masa sigurimi personal** ka një rritje të masave prej 140 çështje të gjykuara.

1. **Tirana** 821 çështje në vitin 2020, në 857 çështje në vitin 2021, ka një rritje prej 36 çështje.
2. **Kruja** 80 çështje në vitin 2020, në 147 çështje në vitin 2021, ka një rritje prej 67 çështje.
3. **Kurbini** 37 çështje në vitin 2020, në 62 çështje në vitin 2021, ka një rritje prej 25 çështje.
4. **Dibra** 52 çështje në vitin 2020, në 51 çështje në vitin 2021, ka një zbritje prej 1 çështje.
5. **Mati** 19 çështje në vitin 2020, në 32 çështje në vitin 2021, ka një rritje prej 13 çështje.

Duhet thënë se statistika e çështjeve të themelit të gjykuara në Gjykatën e Apelit Tiranë, është ndikuar në mënyrë të drejtëpërdrejtë nga fakti se trupa gjyqësore e Gjykatës së Apelit Tiranë, gjatë vitit 2021, pati procesin kalimtar të vlerësimit nga organet e vetingut, çka solli uljen ndjeshëm të numrit të trupës gjyqësore, e cila funksionoi me vetëm dy trupa.

E njëjta situatë, përfshiu dhe Prokurorinë e Apelit, e cila e geti veten efektivisht me tre prokurorë deri në muajin nëntor të vitit 2021, nga nëntë që ka patur struktura.

Për më tepër, duhet theksuar se shqyrtimi i ankimeve ndaj vendimeve të pushimit të procedimeve penale, realizohen në dhomë këshillimi nga ana e gjykatës, pa prezencën e palëve, çka ndikon dhe në numrin e përgjithshëm të përfaqsimit të organit të akuzës.

2.3. Nisur nga volumi i natyrës së çështjeve, faktori që ndikon në numrin e çështjeve të veçanta gjatë vitit 2021, është ai që lidhet me shqyrtimin e ankimeve të vendimeve gjyqësore të seancës paraprake, pas ndryshimeve me ligjin nr. 35 / 2017 në Kodin e Procedurës Penale.

2.4. Gjithashtu gjatë vitit 2021, nga Prokurorët e Apelit janë kryer detyrimet ligjore në fushën e **ekzekutimit të vendimeve** penale, ku janë **579** raste të nxjerjes së urdhërave të ekzekutimit, që lidhen me vendimet me ekzekutim të menjëherëshëm të Gjykatës së Apelit Tiranë.

Numri i urdhërave të ekzekutimit të prokurorëve të apelit gjatë vitit 2021, është disi më i lartë se i atyre të nxjerrë gjatë vitit paraardhës, kur ishin **492** të tillë.

### **3. ANALIZA E TREGUESVE TË EFEKTIVITETIT TË PUNËS PËR ÇËSHTJET E THEMELIT.**

3.1. Për **çështjet e themelit**, në total, gjatë vitit 2021 nga prokurorët është përfaqësuar akuza në Gjykatën e Apelit Tiranë për **349 çështje**, me **431** persona të **pandehur**, nga të cilët **249** kanë qenë **të arrestuar** dhe sipas rretheve gjyqësorë të dhënët paraqiten si vijon:

6. **Tirana** 268 çështje me 344 të pandehur prej të cilëve 195 të arrestuar
7. **Kruja** 28 çështje me 34 të pandehur prej të cilëve 19 të arrestuar
8. **Kurbini** 27 çështje me 27 të pandehur prej të cilëve 18 të arrestuar
9. **Dibra** 16 çështje me 16 të pandehur prej të cilëve 11 të arrestuar
10. **Mati** 10 çështje me 10 të pandehur prej të cilëve 6 të arrestuar

Përsa i përket çështjeve të themelit, kanë ardhur dhe janë gjykuar, mbi **apelin e prokurorit** të shkallës së parë, **60 çështje** dhe mbi **ankimin e të pandehurve** **289 çështje** ose **78.5% të rasteve**.

1. **Tirana** ka 43 apele, janë përkrahur nga Prokurori 24 apele, nga të cilat gjykata ka pranuar 7 apele. Nga ana e prokurorëve është hequr dorë dhe ështe kërkuar mospranimi i ankimit në 19 raste.

2. **Kruja** ka 4 apele, janë përkrahur nga Prokurori 4 apele, nga të cilat gjykata ka pranuar 1 apel.
3. **Kurbini** ka 7 apele, janë përkrahur nga Prokurori 6 apele, nga të cilat gjykata ka pranuar 3 apele. Nga ana e prokuroreve është hequr dorë dhe eshte kërkuar mospranimi i ankimit në 1 raste.
4. **Dibra** ka 3 apele, eshtë përkrahur nga Prokurori 1 apel, nga të cilat gjykata nuk ka pranuar asnje apel. Nga ana e prokuroreve është hequr dorë dhe është kërkuar mospranimi i ankimit në 2 raste.
5. **Mati** ka 3 apele, është përkrahur nga Prokurori 1 apel, nga të cilat gjykata nuk ka pranuar asnje apel. Nga ana e prokurorëve është hequr dorë dhe është kërkuar mospranimi i ankimit në 2 raste.

3.2 Prokurorët kanë përkrahur apelet në shumicen e rasteve.

3.3 Në gjykimin e çështjeve të apeluara, në **38** raste kërkesat e **prokurorit të apelit** kanë qenë për ndryshim të vendimit të shkallës së parë dhe **rëndim** të pozitës së të pandehurit, për të cilat Gjykata e Apelit Tiranë ka vodosur si vijon :

- në **23** çështje e ka **lënë në fuqi** vendimin
- në **11** çështje e ka ndryshuar vendimin duke **rënduar** pozitën e të pandehurit
- në **3** çështje e ka ndryshuar vendimin duke **lehtësuar** pozitën e të pandehurit në
- **1** rast e ka prishur vendimin dhe ka vodosur prishje vendimi, kthim te akteve,

3.4 Në gjykimin e çështjeve të apeluara, në **11** raste kërkesat e prokurorit të apelit kanë qenë për ndryshim të vendimit të shkallës së parë lehtësim të pozitës së të pandehurit nga të cilat janë pranuar kërkesat në **9** raste dhe **2** raste janë lënë në fuqi nga Gjykata.

Në **5** raste është kërkuar nga ana jonë pushimi i çështjes dhe është pranuar nga Gjykata.

Në **4** raste është kërkuar nga ana jonë, Prishje vendimi e kthim të akteve, dhe është pranuar nga Gjykata.

Në gjykimin e çështjeve të apeluara, në **291** raste , kërkesat e **prokurorit të apelit** kanë qenë për **lenie në fuqi** të vendimit të shkallës së parë, për të cilat Gjykata e Apelit Tiranë ka vodosur si vijon :

në **250** çështje e ka **lënë në fuqi** vendimin

në **35** çështje e ka ndryshuar vendimin, duke **lehtësuar** pozitën e të pandehurit dhe në **3** raste e ka prishur vendimin dhe ka **pushuar** çështjen.

në 3 raste e ka prishur vendimin dhe ka kthyer çështjen për **rigjykim**

Ndër çështjet e apeluara, në **118** raste Gjykata e Apelit ka vendosur **mospranimin** e apelit, ndër të cilat në **24** raste është hequr dorë nga prokurorët e apelit (që është një numër shumë më i ulët se vitin e kaluar), kurse në **94** raste të tjera është disponuar **nga gjykata** për mosplotësim të shkaqeve formale të apelimit.

3.5. Nga numri i çështjeve në tërësi Tirana zë numrin më të madh të çështjeve të gjykuara, **268** çështje ose 76.7%, më pas vjen Kurbini me **27**, çështje ose 7.7 % të çështjeve, Kruja me **28** çështje ose 8.3 %, Dibra me **16**, çështje ose 4.5 % dhe Mati me **10** çështje ose 2.8%.

Gjatë vitit 2021, prokurorët e apelit kanë ushtruar **rekurs** mbi vendimet për **çështjet e themelit** të Gjykatës së Apelit në **12** raste.

Më poshtë po ju paraqesim në mënyrë të përmbledhur ngarkesën e prokurorëve:

#### Për Çështje Themeli

Nr.	Prokurori	Çështje	Apele te prokuror	Apel te pand	Pr.Apeli	H.Dore	Pr.Apeli Gjykata	Rekurse
1	Arben Qosja	114	22	92	19	3	4	7
2	Arta Marku	123	21	102	11	10	5	5
3	Genti Xholi	110	17	93	6	11	2	-
5	Eridiana Kasa	2	-	2	-	-	-	-
	Total	349	60	289	36	24	11	12

**349** çështjet e gjykuara në vitin 2021, sipas objektit të gjykimit janë:

**251** çështje janë me objekt themeli që i përkasin (fajësisë, cilësimit ligjor, llojit, masës dhe alternativave të dënimit).

**98** çështje janë me objekt administrativo penal (kundërshtim i vendimeve të prokurorit, etj).

E zberthyer sipas objektit te gjykimit (çështje themeli) sipas ankuesit dhe rretheve, paraqitet si më poshtë vijon:

Ankime 2021 <u>Themel</u>	Gjithsej	Tiranë	Krujë	Kurbin	Diber	Mat
Totali	349	268	28	27	16	10
Ankim pandehuri/persona nën hetim/ i demtuari	289	237	12	20	7	13
Ankim Prokurori	60	43	4	7	3	3

Gjatë vitit 2021 rezulton se janë gjykuar në dhomë këshillimi edhe 110 (njëqind e dhjetë) procedime themeli, (*të pa përfshira në tabelë*) ( mosfillime, pushim çështje, bashkim dënim, dhe vepra të tjera penale).

Për të patur sukses është shumë i rëndësishëm organizimi i punës, ku janë marrë masa që shpërndarja e punës të bëhet në funksion të përfaqësimit dinjitoz në gjyq. Kështu për masat e sigurimit është përdorur sistemi i prokurorëve të gatshëm, me grafikë mujor, duke ruajtur sistemin e radhës sipas grafikut.

Kjo mënyrë organizimi ka qenë efikase, pasi në të gjitha masat e sigurimit ne jemi përfaqësuar në orën e datën e caktuar për gjykim dhe nuk ka as dhe një rast që çështja të mos jetë zhvilluar për shkak të mungesës së prokurorit.

Për çështjet e themelit nga ana ime është treguar kujdes që trajtimi e ndarja e çështjeve midis prokurorëve të jetë e barabartë, jo vetëm duke u nisur nga numri, por edhe nga shkalla e rrezikshmërisë dhe e rëndesisë së çështjes, numrit të pandehurve, ndarje në mënyrë të barabartë të çështjeve që gjykohen në apel mbi bazën e ankimeve të prokurorëve dhe ankimeve të bëra nga ana e palëve të tjera në procesin penal.

Nga Gjykata e Apelit tashmë është një praktikë e konsoliduar që çështjet e themelit na vihen në dispozicion për tu studiuar të paktën 1 muaj para fillimit të gjykimit. Kjo na ka mundësuar që prokurorët të kenë kohë të mjaftueshme për ti studiuar e për pasojë për tu përfaqësuar në gjykim në mënyrë dinjitoze.

Për sa i përket të dhënave analitike të detajuara dhe të analizuara më lart, duhet thënë se ato përfaqësojnë çështjet penale të planifikuara për gjykim, pra ato që gjyqtarët kanë nxjerrë për shqyrtim gjyqësor e që janë përfunduar gjatë vitit 2021.

**Ndërkohë këto të dhëna, nuk përbajnë ato që përfaqësojnë gjendjen reale të ngarkesës së Gjykatës së Apelit, pra çështjet që presin për tu planifikuar për gjykim. Kështu duke ju referuar të dhënave që na vuri në dispozicion Gjykata e Apelit, rezulton se për në fund të vitin 2021, në pritje për tu gjykuar mbeten 3500 çështje penale, të cilat i përkasin viteve të ndryshme.**

Pikërisht duke u nisur dhe nga kjo situatë, të dhënrat analitike si për ankimet e paraqitura nga prokurirtë e rretheve, situata e çështjeve referuar veprave penale konkrete, që po Ju pasqyrojmë në këtë raport, përbëjnë thjesht gjënë e gjykuar por jo atë që është në pritje të gjykokhet.

Kjo e dhënë nuk disponohet nga ana e Prokurorisë së Apelit Tiranë, pasi ajo vihet në lëvizje nga ana e Gjykatës së Apelit, kur gjyqtarët planifikojnë cështjen konkrete për gjykim dhe në atë moment dosja fizike na vihet në dispozicion.

#### **4. ANALIZA E TREGUESVE TË EFEKTIVITETIT TË PUNËS PËR ÇËSHTJET E MASAVE TË SIGURIMIT.**

4.1. Në gjykin e masave të sigurimit, **në total** gjatë vitit **2021** nga prokurorët është përfaqësuar akuza në Gjykatën e Apelit Tiranë për **1149 persona** (vitin paraardhës ishin **1009**), ku sipas rretheve gjyqësore të dhënrat paraqiten si në vijim :

- **1051** persona (857 çështje) për masa sigurimi nga Prokuroria e rrethit **Tiranë**,
- **190** persona (147 çështje) për masa sigurimi nga Prokuroria e rrethit **Krujë**,
- **68** persona (62 çështje) për masa sigurimi nga Prokuroria e rrethit **Kurbin**,
- **71** persona (51 çështje) për masa sigurimi nga Prokuroria e rrethit **Dibër**,
- **42** persona (32 çështje) për masa sigurimi nga Prokuroria e rrethit **Mat**.

4.2. Nga ky numër i çështjeve të përfaqësuara në Gjykatën e Apelit, për **124** prej tyre **apelues** kanë qenë **Prokuroritë** e Shkallës së Parë, kurse për pjesën tjeter **1025**, apelues kanë qenë të pandehurit, ku sipas rretheve gjyqësorë të dhënat paraqiten si vijon :

- Prokuroria e Rrethit Gjyqësor **Tiranë** – **71** apelime të prokurorëve.
- Prokuroria e Rrethit Gjyqësor **Krujë** – **13** apelime të prokurorëve.
- Prokuroria e Rrethit Gjyqësor **Kurbin** – **27** apelime të prokurorëve.
- Prokuroria e Rrethit Gjyqësor **Dibër** – **5** apelime të prokurorëve.
- Prokuroria e Rrethit Gjyqësor **Mat** – **8** apelime të prokurorëve

4.3. Në **122** raste të **apelimeve** për masat e sigurimit, Gjykata e Apelit Tiranë ka vendosur **mospranimin** e tyre, ndër të cilat në **57** raste është hequr dorë nga prokurori i apelit ku sipas rretheve gjyqësore të dhënat paraqiten si vijon :

- Prokuroria e Rrethit Gjyqësor **Tiranë** – **84** vendime gjyqësore mospranimi, per **33** prej të cilave është hequr dorë nga prokurori.
- Prokuroria e Rrethit Gjyqësor **Krujë** – **17** vendime gjyqësore mospranimi, per **10** prej të cilave është hequr dorë nga prokurori.
- Prokuroria e Rrethit Gjyqësor **Kurbin** – **13** vendime gjyqësore mospranimi, per **11** prej të cilave është hequr dorë nga prokurori.
- Prokuroria e Rrethit Gjyqësor **Dibër** – **4** vendime gjyqësore mospranimi, per **1** prej të cilave është hequr dorë nga prokurori.
- Prokuroria e Rrethit Gjyqësor **Mat** – **4** vendime gjyqësore mospranimi, per **2** prej të cilave është hequr dorë nga prokurori.

4.4. Në **155** raste të apelimeve për masat e sigurimit (Tiranë – 103, Krujë – 17, Kurbin – 18, Dibër – 10 dhe Mat 7), **Prokurori i Apelit** ka kërkuar **ndryshimin** e vendimit si vijon:

- Në **65** raste (Tiranë – 36, Krujë – 3, Kurbin – 16, Dibër – 4 dhe Mat -6) Prokurori i Apelit ka kërkuar caktimin e masës së sigurimit “**arrest në burg**”, sipas apelimit të prokurorit të shkallës së parë,

- Në 90 raste (Tiranë – 67, Krujë – 14, Kurbin – 2, Dibër – 6 dhe Mat 1) Prokurori i Apelit ka kërkuar caktimin e masave të sigurimit më të buta nga vendimi i shkallës së parë.

4.5. Për këtë kërkim të Prokurorit të Apelit, **Gjykata** e Apelit Tiranë ka **vendosur** si vijon :

- Në 20 raste (Tiranë –11, Kurbin – 6, dhe Mat 3 ) ka caktuar masën e sigurimit “**arrest në burg**”, sipas apelimit të Prokurorit të Shkallës së Parë,
- Në 83 raste (Tiranë – 58, Krujë – 14, Kurbin – 3, Dibër – 6 dhe Mat 2) ka caktuar masa sigurimi më të **buta** nga vendimi i shkallës së parë.
- Në 52 raste (Tiranë – 34, Krujë – 3, Kurbin – 9, Dibër – 4 dhe Mat 2) ka **lënë në fuqi** vendimin e shkallës së parë.

4.7. Në 944 raste (Tiranë – 754, Krujë – 130, Kurbin – 44, Dibër – 41 dhe Mat 25) kryesisht për ankime të të hetuarve, **prokurori** ka kërkuar **miratimin e vendimit** të shkallës së parë.

4.8. Për këtë kërkim të Prokurorit të Apelit, **Gjykata** e Apelit Tiranë ka **vendosur** si vijon :

- Në 832 raste (Tiranë – 644, Krujë – 97, Kurbin – 37, Dibër – 32 dhe Mat 22) ka **miratimin e vendimit** të Gjykatës së Shkallës së Parë,
- Në 160 raste (Tiranë – 109, Krujë – 32, Kurbin – 7, Dibër – 9 dhe Mat 3) ka caktuar masa sigurimi më të **buta** nga vendimi i shkallës së parë.
- Në 2 raste (Tiranë – 1, Krujë – 1) ka **shfuqizuar** vendimin të shkallës së parë.

4.9. Për çështjet që lidhen me **masat e sigurimit**, Prokurorët e Apelit kanë ushtruar të drejtën e **rekursit** në Gjykatën e Lartë në 8 raste.

## 5. TË DHËNAT MBI NGARKESËN E PUNËS PËR ÇDO PROKUROR.

Gjatë vitit 2021 ngarkesa e punës për çdo prokuror ka qenë në nivele më të larta se viti i kaluar, tregues në të cilin ka ndikuar edhe pakësimi i numrit të prokurorëve të zyrës.

Ndërkohë ngarkesa midis prokurorëve është në nivele të përafërtë, çka është tregues i një organizimi të mirë të brendshëm të punës dhe që përbën përbushje të detyrimit ligjor për ndarjen e barabartë të punës në Prokurori.

Të dhënat mbi ngarkesën e punës për çdo prokuror, ku përfshihet edhe përfundimi i çështjeve të mbartura nga viti 2020, në përfaqësimin e çështjeve të ndryshme në Gjykatën e Apelit Tiranë për vitin 2021, paraqiten si në vijim.

### 10.1 Për masa sigurimi

Nr	Prokurori	Shuarje mase	Masa	Total masa	Apel prok	Pr.Apel	H.Dore	Pranuar Gjykata	Rekurse
1	A.Qosja	60	268	328	22	16	6	5	2
2	A.Marku	6	281	287	38	19	19	8	5
3	G.Xholi	119	380	449	57	29	28	4	1
4	L.Riza	5	15	20	3	1	2	0	0
5	A.Ndoi	1	14	15	4	2	2	0	0
	Total	191	958	1149	124	67	57	20	8

E zberthyer sipas objektit të gjykimit (*vlefësim dhe caktim mase, zëvendësim mase sigurimi, shuarje mase dhe të tjera*) të ndara sipas rretheve gjyqësore; paraqitet si më poshtë vijon:

Ankime 2021 <u>Masa sigurimi</u>	Gjithsej	Tiranë	Krujë	Kurbin	Diber	Mat
Totali	1149	857	147	62	51	32

Ankim pandehuri/persona nën hetim/ i demtuari	1025	786	134	35	46	24
Ankim Prokurori	124	71	13	27	5	8

## 6. INFORMACION MBI ADMINISTRIMIN E PROKURORISEË.

Gjatë vitit 2021 edhe personeli administrativ i kësaj zyre, ndonëse i kufizuar numerikisht, e ka kryer me korrektesë detyrën e vet duke qenë mbështetje për prokurorët në përballimin e kësaj ngarkese në punë.

Në këtë drejtim është për tú theksuar veçanërisht puna e kryer nga kryesekretarja e kësaj zyre, e cila në mungesë të organikës kryen edhe detyrën e sekretares pranë prokurorëve, si dhe ato të financës dhe të arkivës.

Vazhdon të mbetet vakant vendi i Kancelares.

### 6.1 Administrata

Gjatë vitit 2021, janë nxjerrë disa urdhëra për mbarëvajtjen sa më të mirë të punës të administratës.

1. Është nxjerrë urdhëri nr.06, date 22.04.2021 për “Ngritjen e Komisionit të Ekspertizës pranë Prokurorisë së Apelit Tiranë”. Qëllimi I këtij komisioni është të hartoje listën konkrete të dokumenteve me Rëndësi Historike Kombëtare dhe të atyre me afat ruajtje të përkohshme si dhe të përcaktojë afatet e rujatjes për këto të fundit. Listat shqyrtohen e miratohen nga Komisioni i Ekspertizës dhe titullari i fondkrijuesit. Kjo për dokumentacionin administrativ. Pas miratimit nga ana e Prokurorisë së Përgjithshme të listes Tip me afatet e ruajtjes së dokumenteve administrativë të Prokurorisë së Apelit Tiranë, nga ana jonë është kërkuar asistencë lidhur me përpunimin tekniko-shkencor të dokumentave nga Drejtoria e Pergjithshme e Arkivave (Drejtoria e Inspektimit dhe Trajnimive).

Inspektori rajonal I kësaj drejtorie, I cili na është vënë në dispozicion për ecurinë e punës në sekretari-arkiv, po asiston me ndihmë metodike në procesin e përpunimit tekniko – shkencor të dokumentave.

Pas verifikimit të gjendjes së Arkivës nga inspektori, janë hasur disa probleme teknike në lidhje me përpunimin e dokumentave, pasi dokumentat e arshivuar rezulton të jenë të papërpunuara që prej

vitit 1994 e në vijim. Për shkak të kushteve jo të duhura të ruajtjes së dokumentacionit të këtyre viteve një pjesë e tyre janë dëmtuar për shkak të lageshtirës.

Gjithashtu është komunikuar edhe me Arshivën e Sistemit Gjyqësor për dosjet hetimore që duhet të dorëzohen. Problemi që ne parashtuan është se prokurorët në Prokurorinë e Apelit Tiranë nuk krijojnë dhe nuk disponojnë dosje. Të vetmet akte që krijohen nga prokurorët janë: Konkluzionet përfundimtare të prokurorit, rekurset e prokurorit, informacionet e prokurorëve drejtuar institucioneve përkatëse si dhe Drejtuesit të Prokurorisë dhe korrespondenca e brendëshme me këtë të fundit.

Këto akte janë pjesë e materialeve të minidosjeve të krijuara, ku pjesa tjeter e dosjes janë materiale fotokopje, pa vlerë arshivore. Edhe për këtë proces nevojitet një punë e madhe për të bërë të mundur përpunimin dhe dorëzimin në Arshivën e Sistemit Gjyqësor sipas rregullave të arkivës.

Pra siç u paraqit më sipër, jemi përpëra një volumi të madh pune të pritshëm që do të realizojë jo vetëm përpunimin e akteve që janë në dorë por më së shumti atyre të mbarturave dhe të papërpunuara në vite (që prej vitit 1994).

Në të tilla kushte është e pamundur që gjithë ky volum pune të përballohet nga arkivistja e institucionit, dhe për këtë arsyë çmojmë se do të ishte shumë e domosdoshme që deri në përfundim të përpunimit të këtyre dokumantave të hershëm dhe krijimit të kushteve normale për vijimin e punës te krijohej mundësia për krijimin e një grupei pune me persona që kanë njohuri mbi arkivat.

Është nxjerrë urdhëri nr.11, datë 28.06.2021 për “Mënyrën e administrimit dhe njoftimit të prokurorëve për rekurset e paraqitura nga palët e tjera në procesin penal”.

Me qëllim administrimin e sakte dhe në kohë të rekurseve të paleve të tjera në proces, të ardhura në adresë të Prokurorisë së Apelit Tiranë dhe informimit të menjëhershëm të prokurorëve rrëth tyre, është krijuar pranë Kryesekretarisë një regjistër I posacëm, ku evidentohet data e ardhjes së rekurseve dhe data e njoftimit dhe vëties në dispozicion të këtyre rekurseve, prokurorëve që I kanë përfaqësuar në Gjykatën e Apelit, kundrejt nënshkrimit, me qëllim realizimin e kundër rekursit kur konsiderohet I nevojshem prej tyre.

Gjithashtu është krijuar edhe një regjistër ku evidentohet data e ardhjes së vendimeve nga Gjykata e Apelit Tiranë dhe data e njoftimit dhe vëties në dispozicion të këtyre vendimeve, prokuoreve që I kanë përfaqësuar këto çështje në Gjykatën e Apelit, kundrejt nënshkrimit.

3. Urdhër nr.14, date 29.07.2021 për “Caktimin dhe autorizimin e punonjësve të Prokurorisë pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, për përdorimin dhe hedhjen e të dhënavës në Sistemin e Integruar të të dhënavës të Drejtësisë Penale për të Mitur”

Jemi duke punuar me sistemin për hedhjen e të dhënavës nga ana jonë.

## 6.2 Financa

Gjatë vitit 2021, buxheti finansiar i kësaj zyre është administruar me korrektesë dhe rigorozitet.

Si pasojë e disiplinës financiare dhe ndihmës gjithëvjetore nga Prokuroria e Përgjithshme, nga ana e kësaj Prokurorie buxheti është realizuar thuajse 100% dhe janë likuiduar të gjitha detyrimet ndaj subjekteve të tjerë dhe personelit.

Po ashtu janë mbajtur të gjithë regjistrat finansiarë, sipas detyrimeve ligjore dhe udhëzimeve të Prokurorisë së Përgjithshme dhe Ministrisë së Financave.

Gjatë vitit 2021 respektimi i disiplinës në punë dhe etikës është mbikqyrur nga drejtuesi i kësaj zyre dhe nuk janë hasur problematika në këtë drejtim.

Bazuar në ligjin nr.10296, datë 8.7.2010, "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", nentit 27, pika 1 si dhe Vendimit nr.27.01.2021 të Këshillit të Lartë Të Prokurorisë është nxjere urdheri i brendeshem nr.5 date 07.04.2021 ku është krijuar Grupi I Menaxhimit Strategjik (G.M.S) ku diskutohen çështje lidhur me menaxhimin e finansiar dhe kontrollin, si dhe për të mundësuar hartimin e kërkesave buxhetore per periudhen pasëardhëse.

Në hartimin e kërkesave të paraqitura në PBA është marrë në konsideratë që të krijohen kushte sa më të përshtatshme, në funksion të rritjes së cilësisë së procesit hetimor dhe kushteve të punës.

### **Shpenzimet për pagat**

Numri total i punonjësve për cdo funksion sipas kategorive, klasave përkatëse (sipas organikës të dërguar nga Prokuroria e Përgjithshme e vitit 2020) Niveli i pagave për çdo kategori është bazuar si më poshtë :

Paga e prokurorëve sipas Ligjit 96/16 date 16.10.2016 "Për Statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", për pagat e reja për prokurorët i cili ka hyrë në fuqi në datën 1/Janar /2019.

Pagat janë llogaritur me strukturen aktuale duke u mbështetur:

Ligjin nr. 96/2016 ,Neni 12,pika 5, gërmë a) ,Vkm 184/17,Vkm 717/2009:

Prokurori pranë Gjykatave të Apelit 98% të pagës referuese G-2

*Paga referuese 118 100*

*Paga Baze*

*115 738 LEKE*

Paga e punonjësve mbështetës sipas Vkm Nr 202 dt 15.03.2017 "Për Disa Ndryshime të Vendimit Nr 717 Date 23.06.2009' të Ndryshuar .(Lidhja nr 2/1)

Në pasqyrë 3/1 është bërë përllogaritja e fondit për orët jashtë orarit, që parashikohen në ditë të shtuna e të diela si dhe ditë festë zyrtare( për prokurorët, Sipas Ligjit nr. 97/2016 "Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë")

Për llogaritjen e kontributit për parashikimin 2022 është patur parasysh pagë maksimale 132312 lekë, mbi të cilën llogaritet kontributi në masën 15 %, Kontributi 1,7% është llogaritur mbi pagën bruto.

Përllogaritja e 601-shit është bërë në bazë të VKM 809 DT 26.12.2018 "Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi", VKM nr. 77 datë 28/01/2015 "Për Kontributet e detyrueshme dhe përfitimet nga sistemi i sigurimeve shoqërore dhe sigurimi i kujdesit shëndetsor ", Vendimin nr 1114, datë 30/07/2008 të Këshillit të Ministrave, "Për disa çështje në zbatim të ligjeve nr. 7703, datë 11.05.1993, "Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, nr. 9136, datë 11.09.2013, "Për mbledhjen e Sigurimeve Shoqërore dhe Shëndetsore në Republikën e Shqipërisë" të ndryshuar dhe nr. 10383 datë 24.02.2011 "Për Sigurimin e Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetsor në Republikën e Shqipërisë".

### **Materiale dhe shërbime zyre.**

Për përcaktimin e këtij fondi i jemi referuar realizimit të viteve të fundit, dhe ecurisë së periudhës faktike të vitit 2020 si dhe parashikimit të vitit 2021. Nuk është planifikuar në zërin e kancelarisë dhe artikulli Letër Format A4 . Ky artikull për vitin 2022 nuk është përfshirë në fondet e prokurorisë pasi do të prokurohet nga Prokuroria e Përgjithshme.

Më të njëjtën procedurë është vepruar dhe me artikullin tonera për fotokopje dhe printeria.

### **Sherbime nga të tretët**

#### **Energjia elektrike.**

Eshtë kërkuar më shume se foni limit duke patur parasysh realizimin e vitit 2020.

#### ***Telefon, Posta shërbimi korrier , shërbim per ruajtje godine:***

Kërkesa përfundit është më e lartë se limiti duke u bazuar në ecurinë e viteve të fundit.

### *Shpenzime transporti.*

Pjesë këmbimi, goma, bateri janë parashikuar 120 mijë ku përfshihen gjithë pjesët e këmbimit të automjeteve dhe shërbime të ndryshme që mund ti kryhet automjetit.

Për përllogaritjen e këtyre shpenzimeve jemi nisur nga fakti i vitit 2020 bazuar në situacionin e fundvitit.

Në Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit Tiranë gjatë vitit 2021 për ushtrimin e veprimtarisë ekonomike –financiare janë celur fondet si më poshtë:

	<b>Plani 2021</b>	<b>Fakti 2021</b>	<b>Realizimi</b>
<b><i>Fondet 2021</i></b>			
<b>Fondi i pagave 600</b>	<b>21 890 000</b>	<b>21 847 106</b>	<b>99.80%</b>
<b>Fondi I.Sig.shoq.shënd 601</b>	<b>2 580 000</b>	<b>2 332 970</b>	<b>90.42%</b>
<b>Shpenzime korrente 602</b>	<b>6 250 000</b>	<b>6 013 707</b>	<b>96.21 %</b>

Fondi i pagave është realizuar në masën 99,80%.

Llogaritja e fondit të sigurimeve shoqërore dhe shëndetsore është bërë sipas ligjeve në fuqi, ku sigurimi shoqëror llogaritet 9.5% mbi pagën maksimale në Republikën e Shqipërisë e cila është 132,312 lekë, kurse sigurimi shëndëtsor dhe kontributi suplementar llogariten mbi pagën bruto.

Lidhur me realizimin e fondit të shpenzimeve korrente realizimi është 96.21%. Peshën më të madhë e zë zëri "Shpenzime për ruajtjen e objektit", që përfshin ruajtjen fizike të ndërtesës dhe aseteve të Prokurorisë Pranë Gjykatës së Apelit Tiranë.

Realizimi i fondeve është në masën 99,4%.

## **7. OBJEKTIVAT PËR VITIN 2022.**

Nga analiza në tërësi e treguesve që u përmendën më sipër, per vitin 2022 prioritetet kryesore të Prokurorisë së Apelit Tiranë do të jenë si në vijim :

- Përfundimi sa më parë i të gjitha çështjeve penale të mbartura në gjykim.
- Vazhdimi i ndjekjes me përparësi të përfaqësimit të akuzës në çështjet e ankimuara që janë në fokus të Rezolutës së Kuvendit të Shqipërisë dhe Planit të Veprimit në zbatim të saj, rekomandimeve të Këshillit të Ministrave dhe urdhërave e udhëzimeve të Prokurorit të Përgjithshëm, sidomos ato që lidhen me krimet kundër jetës të kryera me dashje, ato në fushën e krimit ekonomik dhe korrupsionit, kundër rendit e sigurisë publike dhe trafiqeve të të gjitha llojeve, veprat penale kundër drejtësisë, ato që cënojnë sistemin demokratik të zgjedhjeve etj.
- Rritjen e nivelit cilësor të përfaqësimit të akuzës në apel.
- Rritjen e nivelit cilësor të rekurseve në Gjykatën e Lartë.
- Konsolidimi i mëtejshëm i bashkëpunimit shumë të mirë me prokuroritë e Rretheve Gjyqësore, me strukturat e Policisë së Shtetit dhe me Prokurorinë e Përgjithshme, pikërisht në funksion të rritjes së cilësisë së përfaqësimit të akuzës në apel.
- Respektimi nga prokurorët i detyrimeve të ligjit procedural penal, ligjit organik të Prokurorisë dhe urdhërave e udhëzimeve të Prokurorit të Përgjithshëm.
- Ruajtjen e figurës së pastër të prokurorëve dhe respektimin prej tyre të normave të solemnitetit në gjykim, etikës dhe të sjelljes së denjë në publik.

## **DREJTUESI I PROKURORISË**

**Genti XHOLI**